



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr. 11760/8 Prot.

Divjakë më 17/11 / 2025

Lënda: **THIRRJE**
“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK DIVJAKË,
MUAJI NËNTOR, 2025”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijëni: **KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË**
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, **Ju njoftojmë se: Më datë: 25 . 11. 2025, ditën e Martë , ora 10:00**, në Sallën e Mbledhjeve, në Godinën e Bashkisë Divjakë, në katin e dytë, thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin **Nëntor 2025**”.

Me këtë Rend dite:

1. Miratim i Rendit të Ditës.
2. Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 24.10.2025.
3. Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Tetor, 2025
4. Projekt-vendim Nr.77 datë.10.11.2025. - Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga Fondi i kushtëzuar deri 6%, për muajin Tetor, 2025.
5. Projekt-vendim Nr.74 datë 03.11.2025 – Për miratimin e një shtese fondi të transfertës së pakushtëzuar sektoriale në buxhetin e vitit 2025.
6. Projekt-vendim Nr.75 datë 05.11.2025 - Për miratimin e projektit “ Rishikim i projektit të ujitjes me presion për skemën e ujitjes Divjakës”
7. Projekt-vendim Nr.76 datë 07.11.2025 – Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Bashkisë Divjakë, në zbatim të VKM. Nr. 435 datë 26.06.2024 “ Për një shtesë në VKM.Nr. 867 datë, 10.12.2014 “ Për proçedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”
8. Projekt-vendim Nr.78. datë . 14.11.2025 - Për miratimin e përfundimit të proçedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK, pranë Drejtorisë vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
9. Projekt-vendim Nr.79.datë 14.11.2025 Për miratimin e “ Paketës Fiskale “Për sistemin e Taksave,Tarifave Vendore dhe Penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2026” , Bashkia Divjakë.
10. Projekt-vendim Nr. 80 datë 14.11.2025 Për“Miratimin e Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Divjakë” si dhe miratimin e Metodologjisë LOD për Financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile”

Njoftim: Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:

-Për pikat Nr: **4,5,7,8,9,10:**Komisioni i Ekonomisë dhe i financave.- Për pikën **6**, Komisioni i Urbanistikës, Infrastrukturës dhe Strehimit.

Duke ju falenderuar !

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Liri Bili

